



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA DELVINE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Delvinë, më 03.02.2022

### Shpallje për vendë të lirë pune - Policia Bashkiake

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr.8224, datë 15.05.1997 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, të ndryshuar, në “Urdhërin e përbashkët për miratimin e Rregullores së brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake dhe të Komunës”; Vendimit Nr.313, datë 01.07.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar; Ligjit Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Urdhërit të Kryetares së Bashkisë nr.257 Prot, datë 01.02.2022 ”Për miratimin e strukturës së administratës dhe institucioneve në varësi të Bashkisë Delvinë për vitin 2022”.

#### **Bashkia Delvinë shpall konkursin për vende të lirë pune në pozicionin:**

- 1 (një) Inspektor (Shef i Seksioni ) i **Policisë Bashkiake, Bashkia Delvinë**

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e lartë në Akademinë e Rendit ;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të most ë jenë liruar nga detyra për shkelje të rënda në kryerjen e detyrës dhe për vepra penale të kryera;

#### **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- a- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- b- Curriculum Vitae;
- c- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- f- Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave e noterizuar;
- g- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- h- Fotokopje e librezës së punës.

- i- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
  - j- Raport mjeko-ligjor për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
  - k- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
  - l- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi);
  - m-Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor);
  - n- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
  - p- 2 Fotografi (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).
- Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në pranë Zyrës me Një ndalesë në Bashkinë Delvinë deri më datën **16.02.2022, ora 16:00.**

## **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT**

Duke filluar nga **23.02.2022**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Delvinës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e zyrtare të Bashkisë Delvinë , në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat dhe dokumentacionin e kërkuar, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së e-mail.Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen brenda **2 ditëve** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvinë .

## **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- b- Njohuritë mbi ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar);
- c- Njohuritë mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës;

## **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

**Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a-Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, intervistës me gojë , Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Delvinës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në standat e informimit të publikut. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvinë . Afati i ankimimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve .

**BASHKIA DELVINË**